



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina

### EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së tetë të Kuvendit, mbajtur më 01.10.2021, e cila filloi në orën 10:00.

**Në mbledhje morën pjesë:** Agim Kuleta, kryesues i Kuvendit, këshilltarët e Kuvendit: Vala Peshku, shefe e GP-së (PSD), Bashkim Beha (PSD), Genc Sherifi (PSD), Mimoza Sylejmani (PSD), Visare Gashi- Gorani (PSD), Qëndrim Sahiti (PSD), Leonora Shabani - Bajraktari, shefe e GP-së (LVV), Arbër Vokri (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Egzon Azemi (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Berat Lahu (LVV), Nazlie Bala (LVV), Halim Halimi, shef i GP-së (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Sami Salihu (LDK), Milazim Vitija (LDK), Agim Gashi (LDK), Shefki Gashi (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Haki Dragusha (LDK), Vjollca Rizani (LDK), Jeta Rafuna - Hasani (LDK), Elmire Nikçi - Rexha (LDK), Shefqet Osmani (LDK), Kushtrim Sopa (LDK), Kumrije Shabani - Ramadani (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Suzan Kika, (PDK), Florida Canolli (PDK), Fadil Gashi, shef i GP-së (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Bukurie Canolli (AAK), Fiknete Bejta (Grupi i pavarur), Vesel Makolli, shef i GP-së (AKR), Adelina Fazliji (AKR), Arbenita Murseli (AKR), Sami Boroci (AKR), Granit Shala (Nisma), Rifat Deri (i pavarur) dhe Valbona Petrovci (e pavarur).

**Munguan:** Migjen Shala (PDK), Blerand Stavileci, shef i GP-së (PDK), Naim Hoxha (LVV), Drilon Pireva (PSD), Nol Nushi (PSD), Sokol Berisha (Grupi i pavarur), Naime Osmani (LDK) dhe Kreshnik Smajlaj (Grupi i pavarur).

**Të pranishëm ishin edhe:** Shpend Ahmeti, kryetar i Komunës, Selim Pacolli, nënkryetar i Komunës, Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Adrian Berisha, drejtor i Drejtorisë së Kulturës, Genc Bashota, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Fatime Hajdari, drejtoreshë e Drejtorisë së Parqeve, Medina Braha, drejtoreshë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Valbona Ajeti, drejtoreshë e Drejtorisë së Kadastrit, Fitim Rexha, drejtor i Drejtorisë së Sportit, Osman Bllaca, përfaqësues i ekzekutivit, përfaqësuesit e KFOR-it, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve dhe përfaqësues të medieëve.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Agim Kuleta, kryesues i Kuvendit dhe e hapi diskutimin rreth rendit të ditës..

### Faqe 1 nga 6

**Fiknete Bejta**, në emër të Komisionit të aksionarëve të NPL-së “Kuzhina Qendrore” kërkoi që në rend të ditës të futet një kërkesë për subvencionimin e kësaj ndërmarrjeje.

**Leutrim Retkoceri** kërkoi që në rendin e ditës të futet edhe pika “ Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të Komunës së Prishtinës.

**Shpend Ahmeti**, kryetar, tha se ky plotësim-ndryshim i kësaj rregulloreje del në diskutim publik, por paraprakisht procedura e ndryshimit të rregullores është, se ndryshimi i saj bëhet në ekzekutiv apo në Kuvend komunal, dhe pas komenteve rregullohet dhe kthehet në votë përfundimtar.

**Egzon Azemi** e ripërsëriti kërkesën që në rendin e ditës të futet për diskutim edhe “Shkarkimi i dy aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Banesore”, me arsyetimin se në lagjen “Lakërishta” është rrënuar një objekt, i cili kulmin e saj e ka me material azbesti dhe se ky objekt është rrënuar në ora 5:00 të mëngjesit, fshehurazi, andaj dhe për këtë ngjarje dikush duhet të japë përgjegjësi.

**Mimoza Sylejmani** kërkoi të dijë se gjithë këto propozime më shumë pika të rendit të ditës, a mund të realizohen, pasi që Kuvendi është në përfundim të mandatit.

**Shpend Ahmeti**, kryetar, tha se sipas nenit 5.2 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, kryetari, ekzekutivi dhe Kuvendi komunal vazhdojnë funksionet normale deri në ditën e inaugurimit të institucioneve të reja.

**Halim Halimi** kërkoi që të gjithë ata drejtorë të cilët kanë propozimprojekte për buxhetin e vitit 2022, të jenë prezent, për ndryshe nuk mundemi të votojmë për çështje të cilat janë shumë të paqarta e janë paraparë në buxhet.

**Shpend Ahmeti**, kryetar, kërkoi që në rend të ditës të futen dy pika dhe të votohen: “Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve NPL-së “Kuzhina Qendrore”, SHA, në Prishtinë” dhe “Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve për organizimin e Kampionatit botëror universitar në hendboll”.

**Kryesuesi** konstatoi se më 37 vota për, 1 kundër dhe 1 abstenim, u miratua propozimi “Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve NPL-së “Kuzhina Qendrore”, SHA, në Prishtinë”, që të futet në rend të ditës për diskutim.

**Kryesuesi** konstatoi se më 5 vota për dhe 22 kundër, nuk u miratua propozimi: “Shkarkimi i dy aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Banesore”, që të futet në rend të ditës për diskutim.

Kryesuesi konstatoi se më 30 vota për dhe 2 kundër, u miratua propozimi: "Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve për organizimin e Kampionatit botëror universitar në hendboll", që të futet në rend të ditës për diskutim.

Me plotësimet dhe ndryshimet e dhëna, Kryesuesi konstatoi se më 34 vota për, 3 kundër dhe 2 abstenime, u miratua ky

#### Rend i ditës:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së shtatë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës;
2. Propozimvendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2022 dhe Korniza afatmesme buxhetore për periudhën 2022-2024;
3. Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve NPL "Kuzhina Qendrore", SHA, në Prishtinë;
4. Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve për organizimin e Kampionatit botëror universitar në hendboll;
5. Pyetje dhe përgjigje;
6. Të ndryshme.

#### Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së shtatë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 30 vota për, u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së shtatë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

#### Pika e dytë

Propozimvendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2022, dhe Korniza afatmesme buxhetore për periudhën 2022-2024.

Lidhur me Propozimvendimin për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2022, dhe Korniza afatmesme buxhetore për periudhën 2022-2024, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Shpend Ahmeti, kryetar.

Halim Halimi në emër të GP të LDK-së, kërkoi nga nënkryetari i Komunës, z. Selim Pacolli, që të qartësojë një projekt të investimeve kapitale, se a është fjala për ndërtimin e rrugës "Suka", apo për ndërtimi i rrugës "Svirca".

Lidhur me pyetjet e parashtruara nga z. Halimi, Selim Pacolli, nënkryetar i Komunës, dha sqarime të nevojshme.

Faqe3nga6

**Agim Gashi** tha se do të ishte mirë që propozimet apo kërkesat tona të merren parasysh, sepse të gjithë jemi të vetëdijshëm që e kemi obligim ligjor votimin e buxhetit. Edhe grupi ynë parlamentar ka disa propozime të tjera, që ne mendojmë se janë shumë vitale dhe shumë të rëndësishme, siç janë kanalizimi, faza e tretë, që ka qenë marrëveshje ndërkombëtare për liqenin e Badocit dhe tash nuk figuron në kod buxhetor faza e tretë, e as e dyta nuk është përfunduar. Po ashtu, bëhen mbi dhjetë kilometra rrugë magjistrale në një vendbanim shumë të dendur, pa asnjë metër trotuare, çfarë kuptimi ka kjo me ndërtuar rrugë nëpër male, ku nuk ka banorë e ku ka dendësi të madhe të popullsisë nuk ka trotuare.

Për hir të korrektësisë, të ulemi dhe t'i sistemojmë këto projekte dhe pastaj t'i votojmë në Kuvend.

**Berat Lahu** tha se në vitin 2017 gjatë fushatës zgjedhore, kryetari i tanishëm i Komunës është zotuar që buxhetin do ta hartojë bashkë me qytetarë, me tubime publike, me diskutim me qytetarët, duke i marrë shqetësimet dhe kërkesat e tyre dhe prurjen e një dokumenti që përfaqëson këto interesa. Sot kur duhet të votohet ky buxhet, ka marrë një qasje tërësisht të kundërt, pra ju bëhet thirrje përfaqësuesve të partive politike të mblidhen atje në qoshe, që të merren vesh kryesisht për interesat e tyre, se cilat projekte do t'i procedojmë më tutje. Konsideroj se kjo qasje e ekzekutivit dhe e përfaqësuesve të partive politike është në kundërshtim me demokracinë, andaj ne si GP i LVV-së nuk marrim pjesë në diskutime të tilla.

**Leutrim Retkoceri**, në emër të GP të PDK-së, tha se arsyetimi i projekteve në kategoritë e shpenzimeve kapitale dhe kategorinë e mallrave dhe shërbime, duhet të bëhet nga propozuesi, përkatësisht nga drejtorët e drejtorive përkatëse para këtij Kuvendi, në mënyrë që të mos përsëritet suficiti gllabërues i mjeteve në vitin 2022. Ne si grup kërkojmë hapjen e kodeve buxhetore dhe plotësimin e tyre.

**Sami Boroci** në emër të GP të AKR-së, tha se ky buxhet i cili na është prezantuar, ka projekte që janë prej vitit 2017, të cilat ende sillen nëpër buxhet edhe nuk janë realizuar, dhe kjo për mua jep njëfarë shqetësimi. Propozoi hapjen, ose krijimin e një kodi buxhetor pikërisht tek Drejtoria e Sportit, që klubet e lokaliteteve të caktuara, në këtë rast të lokalitetit të Hajvalisë, të ushtrojnë pa pagesë në stadiumin e Hajvalisë. Këtë shqetësim disa herë e kam ngritur në Kuvend, por deri më sot nuk ka asnjë rezultat konkret lidhur me këtë çështje.

**Fiknete Bejta**, në emër të Grupit të pavarur, tha se në Drejtorinë e Financave i kam paraqitur dy kërkesa: Kam propozuar që buxheti i ardhshëm t'i trajtojë varrezat e Makovcit, me një kosto siç e kemi llogaritur edhe me Agjencinë e Monumenteve, menaxhimin e monumenteve, diku rreth 150 mijë euro, si dhe kam propozuar ndërtimin

e një fushe të sportit në lagjen e Fanollëve në Prapashticë, projekte këto të cilat do të ishte mirë që të përfshihen në këtë buxhet. Propozoi që ky buxhet të votohet me përfshirjen e disa kërkesave që i patën shefat e grupeve parlamentare. Lidhur me shqetësimet dhe propozimet e ngritura nga parafolësit, sqarime shtesë dha **Selim Pacolli**, nënkryetar.

**Egzon Azemi** ceku se, ne si GP i LVV-së, në takimet e mbyllura nuk marrim pjesë, është e drejtë e secilit subjekt me e përcaktuar veten a donë me marr pjesë në ato takime apo jo. Ne gjithëherë çka kemi kërkuar vazhdimisht, ka qenë që me pasur një dozë të sinqeritetit në këtë drejtim.

Herën e kaluar, kur është miratuar buxheti në Kuvendin komunal, secili propozim i secilit subjekt politik ka kaluar, me përjashtim të propozimeve të dhëna nga LVV-ja, ku dhjetë prej tyre që i kemi bërë, asnjë prej atyre propozimeve nuk ka kaluar.

**Vala Peshku** kërkoi të dijë arsyen e mos përfshirjes së Manifestës në këtë buxhet. Po ashtu ceku se nuk është hera e parë që janë mbledhur grupet parlamentare rreth buxhetit, ku ne kemi pasur diskutime edhe viteve të kaluara, dhe kjo është një procedurë komplet e bukur mund të them për një Kuvend, ku në marrëveshje, në bashkëbisedim gjithçka kur ka komunikim të shëndoshë i gjendet zgjidhja. Mirë që është përmirësuar pakëz buxheti, po mendoj në kuptimin që janë futur edhe kërkesat që kanë ardhur tani, por nëse nuk është aq i mirë, le të urdhërojnë qeverisja e ardhshme në qershor mund ta rishikojë.

Lidhur me shqetësimin e ngritur nga znj. **Vala Peshku**, sqarime të nevojshme dha **Shpend Ahmeti**, kryetar.

**Shefki Gashi** tha se është për të ardhur keq se si është paraqitur ky buxhet, andaj është veç kulmi i absurditetit, kur 32 vendbanime të komunës së Prishtinës nuk përmenden fare, nuk janë të përfshira me këtë buxhet, siç janë vendbanimet, Llukar, Makovc, Prugofc, Mramor, Suteskë, Busi, Hajkobillë, Dabishefc, Shashkovc, si dhe lokalitete të tjera që nuk ndahet asnjë cent nga buxheti i Komunës për realizimin e projekteve të këtyre zonave. Do të ishte mirë që edhe këto vendbanime të përkrahen me mjete buxhetore për realizimin e projekteve të tyre.

**Arbër Vokrrri** nuk u pajtua me mënyrën se si u përpilua, si u korrigjua ky buxhet dhe shprehu mos pajtim për mënyrën se si janë marrë me prioritet projektet, kështu si shembull mund të jetë lagja "Dardania" e cila lagje ka nevojë për shumë projekte e që janë anashkaluar, andaj po hyjnë në prioritet projektet qindra milionëshe që nuk janë hiq në interesin e qytetarëve, pra kjo është njëra prej arsyeve që nuk do ta votoj këtë buxhet.

**Valbona Makolli**, drejtoreshë, në emrin e saj falënderoi të gjithë pjesëmarrësit që ishin bashkëpunues, si në kritika, këshilla, diskutime etj., gjatë gjithë takimeve që patën për qëllim realizimin e projekteve të ndryshme në komunën e Prishtinës.

Kryesuesi konstatoi se, me ndryshimet dhe plotësimet e dhëna, më 26 vota për dhe 3 abstenime, u miratua Vendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2022 dhe Korniza afatmesme buxhetore për periudhën 2022-2024.

**Pika e tretë**

Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve NPL "Kuzhina Qendrore", SHA, në Prishtinë.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 30 vota për, u miratua Vendimi për ndarjen e mjeteve NPL "Kuzhina Qendrore", SHA, në Prishtinë.

**Pika e katërt**

Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve për organizimin e Kampionatit botëror universitar në hendboll.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 30 vota për, u miratua Vendimi për ndarjen e mjeteve për organizimin e Kampionatit botëror universitar në hendboll.

**Pika e pestë**

Të ndryshme

Mimoza Sylejmani e falënderoi drejtoreshën e Drejtorisë së Financave, znj. Valbona Makolli, e cila çdo herë ka qenë prezente në mbledhjet e Kuvendit.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

Procesmbajtësi  
Zijadin Gashi

Kryesuesi i Kuvendit  
Agim Kuleta



Faqe 6 nga 6